

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kallëzohet në SPAK, Petrit Malaj: "Po mbroj ligjin dhe dyert e financave të shtetit" - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/kallezohet-ne-spak-petrit-malaj-po-mbroj-ligjin-dhe-dyert-e-financave-te-shtetit/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 09:25:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 09:21:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9e332b0abc6db11406290808eceb4e9daca2cfd55ad67fe10742fd4057b0733e
TEKSTI	7ac810f82ecb16ceac9f64f6f4233a76b5ddfd4068f634b7ab413d23b34da4c1
PAMJA	029060d256c811b2132f162f0ececfd758199fd7290535907f1d2d0a617087c2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d8b43998c23a38b6ae478be42ec64dd80ccc7a9fa3453bc1637deb8f893df682
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	34a49f1fb4e3ec12662634f6e1a4b8d33a530968e91968fa2be08bb537c32d65
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d8b43998c23a38b6ae478be42ec64dd80ccc7a9fa3453bc1637deb8f893df682>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Kallëzohet në SPAK, Petrit Malaj: “Po mbroj ligjin dhe dyert e financave të shtetit”

by Lajm Lajm — September 19, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Nga Boldnews.al

Prokuroria Speciale SPAK që nga themelimi i saj kurrë nuk ka qenë kaq e shpejtë në hetime si në rastin e skandalit për bllokimin e pagave të gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve të tjerë të administratës në sistemin e drejtësisë.

Paraditen e djeshme u mor në pyetje drejtoresha e thesarit, ndërsa një grup agentësh të BKH-së mbërritën në Ministrinë e Financave ku sekuestruan dokumenta të ndryshëm, kryesisht materiale shkresore dhe e-maile zyrtare që çuan në moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për rritjen e pagave në të gjithë sistemin e drejtësisë dhe mënyrën e përlogaritjes.

Mes personave të kallëzuar për shpërdorim detyre është edhe ministri i Financave, Petrit Malaj. “Kallëzohem sepse po kërkoj të mbroj ligjin dhe mbroj dyert e financave të shtetit”, tha natën vonë në Parlament, ministri i Financave. Ky i fundit duket se po e kërkon vetë fundin, më shpejtë sesa koha ku Rama ia shterron edhe atë pikëz vaji në kandilin që s’po ndriçon.

Po mesnatën e së enjtes, fort i hallakatur edhe në mendime, kryeministri Rama shkoi në Parlament për të dhënë edhe votën e tij në ndryshimet ligjore që mundësojnë zhblokimin e pagave. Formula përlogaritëse e rritjes së pagave është kundërshtuar si nga opozita ashtu edhe magjistratët, por tashmë ky ligji mori fuqi kur presidenti i vendit rendi me shpejtësi në zyrë dhe pa u menduar fare mëngjesin e sotëm dekretoi këtë ligj.

A u shkel ligji dhe kushtetuta e vendit kur qeveria dhe mazhoranca parlamentare refuzoi për të zbatuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese? Këtë më mirë se kushdo e di “sypetriti” i financave që edhe nëse e ka zët të pyesë juristët që ia ka emëruar tjetërkush në ministrinë që thotë se e drejton, mjafton të konsultohet me ndonjë të afërm të besuar, që të paktën të kenë mbaruar semestrin e parë të fakultetit juridik.

Me siguri do ia thotë hapur se ja ka futur fort kot në bllokimin e pagave në sistemin e drejtësisë dhe vepra penale quhet e konsumuar. Në këtë rast është samari që po “ha dru” nga SPAK-u sepse edhe specialët prokurorë as nuk guxojnë ta gudulisin qoftë edhe pak mushkën zezveke që vetëm shkelmon e kafshon këdo.

Sypetriti i financave edhe këtë herë nuk ishte aspak vigjilent që të paktën mos e pësonte kaq trashë, për tu bërë “dëshmor” i kohëve moderne për kryetarin, ashtu si “200 Petritat” që u “flijuan” për partinë dikur...!

TË FUNDIT

Kallëzohet në SPAK, Petrit Malaj: “Po mbroj ligjin dhe dyert e financave të shtetit”

SEPTEMBER 19, 2026

Nafta 219 lekë/litri, benzina 195 lekë, Bordi i Transparencës vendos çmimet tavan

SEPTEMBER 19, 2026

Këmbimi valutor 19 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja

SEPTEMBER 19, 2026

Riorganizimi territorial: Shqipëria mes 46 dhe 100 bashkive

SEPTEMBER 19, 2026

Moti sot/ Kthjellime dhe vranësira, ja ç’na pret

SEPTEMBER 19, 2026

JPMorgan: Nuk e dimë se si do të përfundojë lufta SHBA-Iran/ Analistët për “The Guardian”: Tregu është në ankth për çmimin e naftës

SEPTEMBER 18, 2026

Çmimet rekord të karburantit tronditën BE-në, rriten thirrjet për taksë mbi fitimet e kompanive të energjisë

SEPTEMBER 18, 2026

“1,800 dollarë për të mbyllur llogaritë”? Kush fshihet pas sulmit ndaj protestuesve në Tiranë?

SEPTEMBER 18, 2026

Dhunë pas sfidës Vllaznia-Teuta, tifozët sulmojnë autobusin e klubit durrsak

SEPTEMBER 18, 2026

Tragjedi në Itali, 42-vjeçarja shqiptare përplasat për vdekje nga kamioni i mbetjeve, vajza 9-vjeçare pa gjithë skenën

SEPTEMBER 18, 2026

Previous Post

Nafta 219 lekë/litri, benzina 195 lekë, Bordi i
Transparencës vendos çmimet tavan



Lajm Lajm

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



Parandalohet ngjarja e rëndë në
Rrogozhinë, arrestohet i riu që
kanosi me kallashnikov 35-vjeçar

01

0 SHARES



Skandali/ Policia rrugore shoqëron kamionët e
Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES



Falsifikime dhe shpërdorim detyre, pezullohen 2
zyrtarë në Tiranë

0 SHARES